



Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës
Kosovo Women's Chamber of Commerce
Privredna Komora Žena Kosova



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
Ministarstvo za Inovacije i Prudžetništvo
Ministry of Innovation and Entrepreneurship

GRATË NDËRMARRËSE TË RAJONIT – TAKIMET B2B

04 maj 2018
Prishtinë, Kosovë

Qëllimi:

Synimi i takimet B2B për gratë ndërmarrëse të rajonit është të kapërcehen barrierat rajonale dhe të nxitet bashkëpunimin ekonomik, tregtar në rajon si dhe konkurrueshmëria.

Kjo ngjarje një-ditore pritet të mbledhë pjesëmarrëse nga vendet e rajonit, si: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Sërbia, Mal i Zi, Bosnja dhe Hercegovia, Kroacia dhe Turqia.

Po ashtu, kjo ngjarje do të ofrojë mundësi për partnerët dhe investorët e mundshëm dhe gratë ndërmarrëse nga vendet e Evropës Perëndimore dhe nga diaspora që të eksplorojnë mundësitë e tregut të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Mundësitë:

- Lidhje të reja biznesi
- Më shumë vizibilitet për bizneset
- Zgjerimi i tregut
- Zhvillimi i kapaciteteve
- Rritja e larmisë të furnizueseve
- Identifikimi i partnerëve të mundshëm të biznesit
- Promovimi i biznesit në rajon
- Zbulimi i trendëve dhe mundësive të reja

Sektorët të cilët do të përfshihen:

Tekstil dhe veshmbathje, hotelieri dhe turizëm, përpunimi dhe shërbimet ushqimore, Teknologjia e Informacionit dhe kontraktimi i jashtëm afarist (IT & BPO), ndërtimtari dhe inxhinieri, shërbime (bukuria dhe shëndeti), shitja me shumicë dhe pakicë, artizanate e prodhime shtëpiake, arsim, shërbime mbështetëse dhe konsulencë për bizneset.

REGJISTRIMI ONLINE: https://docs.google.com/forms/d/1a4_zalJv97q-96RrZjHoQqEMAnGuuwuRRoNVabYRm1A/edit

Regjistrimi: deri më 20 prill 2018
Caktimi i takimeve online: 21 – 30 prill 2018
Takimet bilaterale: 04 maj 2018

Pjesëmarrja është falas, po ashtu do të ketë komoditete të tjera për pjesëmarrëset
Kohëzgjatja e takimit: 20 minuta - maksimum 6 takime

Për më shumë detaje ju lutem kontaktoni:
g7kosova@yahoo.com

SI FUNKSIONON

1. REGJISTRIMI:

- Pjesëmarrëset duhen të plotësojnë formularin online dhe të krijojnë profilin e kompanisë së tyre.
- Të paraqesin informacione të qarta për produktet / shërbimet të cilat i ofrojnë.
- Të përshkruajnë fushat e interesit dhe pritjet e tyre.

2. VIZIBILITETI I PROFILIT:

- Pas krijimit të profilit të kompanisë suaj ajo do të bëhet e dukshme për të gjithë pjesëmarrëset.
- Profili i kompanisë do t'ju prezantohet partnerëve afaristë potencial – pjesëmarrës në event.
- Organizatorët e eventit do t'ju ofrojnë përkrahje në kërkim të kompanive me interes dhe arranzhimit të takimeve.

3. CAKTIMI I TAKIMEVE:

- Periudha e caktimit të takimeve fillon më 21 – 30 prill 2018.
- Përfaqësueset e kompanive janë të obliguar të dërgojnë kërkesë për takim partnerëve potencial.
- Takimet të caktohen në bazë të marrëveshjeve reciproke dhe bazuar në interesa të përbashkëta.
- T'ju ktheni përgjigjen partnerëve potencial që kanë shprehur interesim ndaj kompanisë tuaj.